




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Në mbështetje të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.24 të Ligjit Nr. 06/L-055, për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 27 dhjetor 2022,

Miraton:

**RREGULLORE NR. 13/2022
PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS TË KRYETARËVE TË
GJYKATAVE DHE GJYQTARËVE MBIKQYRËS**

**Neni 1
Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Kjo rregullore përcakton parimet, procedurën, kriteret dhe rregullat lidhur me vlerësimin e performancës së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës.
2. Përmes vlerësimit të performancës së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës, synohet ngritja e efikasitetit dhe llogaridhënies në sistemin gjyqësor, promovimi i profesionalizimit, shkathtësisë dhe përgjegjësisë së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës, nxitja në arritjen e rezultateve të mira të punës në gjykata dhe degë të tyre, si dhe në drejtim të ngritjes së besimit të publikut në punën e gjykatave dhe sistemit gjyqësor në përgjithësi.
3. Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen për kryetarin e Gjykatës së Apelit, kryetarin e Gjykatës Komerciale, kryetarët e gjykatave themelore dhe për të gjithë gjyqtarët mbikëqyrës të degëve, duke përfshirë edhe gjyqtarin mbikëqyrës të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, gjatë kohës sa të njëjtit janë duke ushtruar mandatin e tyre në këto pozita, Këshillit, anëtarëve të komisioneve të themeluara me këtë rregullore, si dhe ndaj të gjithë zyrtarëve të tjerë të Këshillit të cilët janë të përfshirë në këtë proces.

Neni 2 **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

- 1.1. **Ligji** - Ligjin Nr. 06/L-054 për Gjykatat;
- 1.2. **Këshilli** - Këshillin Gjyqësor të Kosovës, siç parashihet në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.3. **Kryetari i Gjykatës** - Gjyqtari përgjegjës për menaxhimin e gjykatës dhe sigurimin e funksionimit efikas të saj, siç parashihet në Ligjin për Gjykata;
- 1.4. **Gjyqtari Mbikëqyrës i Dhomës së Posaçme** - Gjyqtari i caktuar në bazë të Ligjit për Dhomën e Posaçme, i cili i përgjigjet Kryetarit të Gjykatës Supreme, për punën e Dhomës së Posaçme;
- 1.5. **Gjyqtari Mbikëqyrës** - Gjyqtari në krye të degës të gjykatës themelore, i cili për veprimet e veta i përgjigjet kryetarit të gjykatës themelore, ashtu siç është paraparë me Ligjin për Gjykatat;
- 1.6. **Sekretariati** – Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, siç parashihet në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.7. **Njësia** - Njësinë për Inspektim Gjyqësor, siç parashihet në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.8. **Komisioni vlerësues** - Komision ad hoc i themeluar me vendim nga Këshilli, përgjegjës për vlerësimin e performancës së kryetarit të gjykatës;
- 1.9. **Anëtar i Komisionit** – Anëtarin e emëruar nga Këshilli, i cili kryen detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me këtë rregullore;
- 1.10. **Anëtar rezervë i Komisionit** – Anëtarin e emëruar nga Këshilli i cili zëvendëson anëtarët e komisionit në rast të konfliktit të interesit apo rastet tjera të pengesave eventuale gjatë ushtrimit të detyrës si anëtar;
- 1.11. **Subjektet për vlerësimin e performancës** – Komisioni vlerësues i themeluar nga Këshilli për vlerësimin e performancës së kryetarit të gjykatës përkatëse dhe kryetar i gjykatës përkatëse për vlerësimin e performancës së gjyqtarit mbikëqyrës;
- 1.12. **Subjekti i vlerësimit** - Kryetari i gjykatës dhe gjyqtari mbikëqyrës;
- 1.13. **Subjektet bartëse të procesit të vlerësimit** - Komisioni vlerësues, kryetari i gjykatës përkatëse, zyrtarët e Njësisë, zyrtarët e Sekretariatit dhe zyrtarët të gjykatave përkatëse;
- 1.14. **Zyrtarët e Njësisë, Sekretariatit, dhe Gjykatës** - Zyrtar përgjegjës të cilët ofrojnë mbështetje profesionale dhe administrative për subjektet përgjegjëse për vlerësimin e performancës së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës.

2. Shprehjet e përdorura në njëjës e kanë të njëjtin kuptim edhe në shumës. Fjalët e përdorura në një gjini përfshijnë edhe gjininë tjetër.

Neni 3 **Parimet e vlerësimit**

1. Vlerësimi i kryetarëve dhe gjyqtarëve mbikëqyrës bëhet në pajtim me parimin e ligjshmërisë, objektivitetit, transparencës dhe barazisë, me qëllim të sigurimit të efikasitetit në ushtrimin e

mandatit të tyre dhe sigurimin e përmbushjes së përgjegjësive të tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2. Vlerësimi i performancës për pozitën kryetar dhe gjyqtar mbikëqyrës i referohet ekskluzivisht punës së tyre menaxheriale gjatë ushtrimit të kompetencave dhe funksionit të tyre në pozitë e lartëcekura, duke përjashtuar vlerësimin e performancës së tyre në kuadër të përgjegjësive dhe funksionit të tyre si gjyqtar.

3. Në rast se nuk parashihet ndryshe me ligj ose rregullore, të gjitha të dhënat dhe informatat e mbledhura gjatë procesit vlerësues të performancës janë konfidenciale. Zbulimi i çfarëdo informacioni nga subjektet bartëse të procesit vlerësues që çënon konfidencialitetin e procesit vlerësues, përbën shkelje disiplinore dhe trajtohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Komisioni për vlerësimin e performancës së kryetarit të gjykatës

1. Për vlerësimin e performancës së kryetarit të gjykatës, Këshilli në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe këtë rregullore, me vendim themelon Komisionin vlerësues.

2. Komisioni vlerësues përbëhet prej tre (3) anëtarëve të rregullt dhe dy (2) anëtar rezervë, të cilët përzgjidhen nga radha e anëtarëve të Këshillit. Anëtar i komisionit nuk mund të jetë gjyqtari që vjen nga gjykata ku kryetari është subjekt i vlerësimit të performancës.

3. Me vendimin me të cilin themelohet Komisioni vlerësues, Këshilli cakton edhe kryetarin e komisionit.

4. Me një kopje të vendimit me të cilin themelohet Komisioni vlerësues njoftohet subjekti i vlerësimit.

Neni 5

Subjekti përgjegjës për vlerësimin e performancës së gjyqtarit mbikëqyrës

1. Për vlerësimin e performancës së gjyqtarit mbikëqyrës në kuadër të fushëveprimtarisë së tij si menaxher në degë të gjykatës themelore, përgjegjës është kryetari i gjykatës përkatëse.

2. Dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, përshtatshëmrisht aplikohet edhe për vlerësimin e performancës të gjyqtarit mbikëqyrës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Neni 6

Periudha e vlerësimit të performancës

Vlerësimi i performancës së kryetarit të gjykatës dhe gjyqtarit mbikëqyrës bëhet dy (2) herë brenda mandatit të tyre pesë (5) vjeçar. Vlerësimi i parë bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) muaj pas marrjes së mandatit, ndërsa vlerësimi i dytë jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas përfundimit të mandatit.

Neni 7

Konflikti i interesit

1. Konflikti i interesit paraqet çdo rrethanë e cila për subjektet bartëse të procesit të vlerësimit të performancës do të konsiderohej si interes privat që ndikon, mund të ndikoj ose duket se do të ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës, ashtu siç përcaktohet me Ligjin Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.
2. Subjektet bartëse të procesit të vlerësimit të performancës duhet të bëjnë përpjekje ta parandalojnë dhe/ose t'i shmangen çfarëdo situatë të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Shfaqja e ndonjë konflikti interesi do të jetë po aq e dëmshme për respektin e publikut për punën e kryer nga Këshilli sikur edhe vet konflikti aktual i interesit.
3. Në rast se gjatë procesit të vlerësimit të performancës, ndonjë subjekt bartës i procesit të vlerësimit beson se mund të ketë konflikt interesi, ai/ajo duhet ta njoftoj menjëherë me shkrim për këtë çështje kryetarin e komisionit përkatës, i cili pas verifikimit të konfliktit të mundshëm të interesit vendos për përjashtimin dhe zëvendësimin e tij/saj.
4. Në rast se konflikti i interesit në procesin e vlerësimit të performancës, paraqitet nga kryetari i komisioni vlerësues, dhe kryetari i gjykatës përkatëse si subjekte vlerësuese, të njëjtit me shkrim e njoftojnë Këshillin, i cili pas verifikimit të konfliktit të mundshëm të interesit vendos për përjashtimin dhe zëvendësimin e tij/saj.
5. Subjektet bartëse të procesit të vlerësimit, me rastin e paraqitjes së konfliktit të mundshëm të interesit detyrohen që menjëherë të pezullojnë çfarëdo veprimi të mëtejshëm, deri sa të vendoset lidhur me përjashtimin dhe zëvendësimin e tij/saj, sipas përcaktimit të bërë me paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni.
6. Në rast se subjektet bartëse të procesit të vlerësimit sipas këtij neni, gjenden në një situatë të konfliktit të interesit me ndonjë nga subjektet e vlerësimit dhe një fakt të tillë e kanë mbajtur të fshehur, për subjektin bartës të procesit, tërheq përgjegjësi disiplinore.

Neni 8

Përgjegjësitë e subjekteve vlerësuese

1. Komisioni vlerësues, vlerësimin e performancës së kryetarit të gjykatës përkatëse e bënë duke respektuar parimin e profesionalizimit, efektivitetit, objektivitetit, konfidencialitetit dhe anonimitetit të procedurës.
2. Pasi që të caktohet subjekti i vlerësimit, anëtarët e komisionit bëjnë organizimin e punës së tyre në atë mënyrë që brenda dy (2) muajve bëjnë vlerësimin e performancës së kryetarit të gjykatës.
3. Anëtarët e komisionit e hartojnë dhe e nënshkruajnë raportin e vlerësimit.
4. Dispozitat e paragrafit 1, 2 dhe 3 të këtij neni, përshtatshëmrisht do të vlejnë dhe zbatohen edhe për kryetarin e gjykatës përkatëse, si subjekt i cili bënë vlerësimin e performancës së gjyqtarit mbikëqyrës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe degën e gjykatës themelore.

Neni 9

Mbështetja administrative

1. Subjekteve për vlerësimin e performancës së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës, gjatë procesit të vlerësimit mbështetje profesionale dhe administrative ju ofrojnë zyrtarët përgjegjës të Njesisë, Sekretariatit dhe gjykatave përkatëse. Njësia është përgjegjëse, për të informuar Këshillin për periudhën se kur duhet të bëhet vlerësimi i performancës së kryetarit të gjykatës dhe gjyqtarit mbikëqyrës, sipas rregullave të përcaktuara me këtë rregullore.
2. Kryetari i Komisionit vlerësues me qëllim të realizimit të vlerësimit të performancës të subjektit të vlerësimit brenda periudhës së përcaktuar në nenin 6 të kësaj rregullore, kërkon nga drejtori i Njesisë apo Sekretariatit të caktohen zyrtarët përgjegjës për mbështetje të komisionit.
3. Kryetari i gjykatës përkatëse me rastin e vlerësimit të gjyqtarit mbikëqyrës në degë / dhomë të Posaçme të Gjykatës Supreme, cakton një zyrtar përgjegjës të gjykatës për mbështetje profesionale dhe administrative, dhe sipas nevojës mund të kërkoj të dhëna edhe nga Njësia, e cila është e obliguar që t'i përgjigjet kërkesës së kryetarit të gjykatës.

Neni 10

Kriteret e vlerësimit të performancës për kryetarin e gjykatës

1. Kryetarët e gjykatave do të vlerësohen në bazë të kriterëve dhe nën kriterëve, përfshirë:
 - 1.1. Organizimi dhe udhëheqja e punës së gjykatës:
 - 1.1.1. organizimi udhëheqja dhe shpërndarja e drejtë me burimet njerëzore;
 - 1.1.2. sigurimi i kushteve për punën e gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe të punësuarave të tjerë;
 - 1.1.3. organizimi dhe mbajta e takimeve të rregullta të punës me gjyqtarë të gjykatës, takimeve me gjyqtarë mbikëqyrës, si dhe me administratën;
 - 1.1.4. raportet tremujore / vjetore të dërguara në Këshill që përfshinë rezultatet, vështirësitë si dhe propozimet për zgjedhjen e problemeve të identifikuara me të cilat ballafaqohet gjykata përkatëse;
 - 1.1.5. zbatimi i planeve strategjike, rregulloreve dhe akteve tjera të miratuara nga Këshilli.
 - 1.2. Efikasiteti i punës së gjykatës:
 - 1.2.1. rezultatet në realizimin e planit vjetor për menaxhimin e lëndëve;
 - 1.2.2. mënyra e caktimit të lëndëve tek departamentet sipas akteve të miratuara në Këshill;
 - 1.2.3. trajtimi i lëndëve të caktuara me prioritet si dhe evitimin e parashkrimit të lëndëve;
 - 1.2.4. seancat e shtyra dhe të anuluarat dhe ndërmarrja e masave për evitimin e shtyrjeve dhe anulimin e seancave gjyqësore;
 - 1.2.5. rezultatet krahasuese në raport me numrin e lëndëve të pranuarat dhe numrin e lëndëve të zgjidhura në të gjitha lëmitë;
 - 1.2.6. përdorimi i SMIL-it dhe monitorimi i përduruesve të saj.
 - 1.3. Transparenca:
 - 1.3.1. krijimin e kushteve për qasjen e qytetarëve pa dallim, përfshirë pjesëmarrjen

e qytetarëve në seancat e hapura për publikun, pranimin e shërbimeve gjyqësore dhe administrative;

- 1.3.2. komunikimi me publikun për çështjet gjyqësore (dita e hapur e gjykatës);
- 1.3.3. tërësinë e komunikatave të lëshuara në lidhje me rastet gjyqësore dhe aktivitete tjera të gjykatës;
- 1.3.4. kualiteti, azhurnimi me të dhëna dhe funksionimi i faqes zyrtare të gjykatës;
- 1.3.5. publikimi i aktgjykimeve dhe aktvendimeve tjera të përcaktuara me akte të miratuara në Këshill për publikim;
- 1.3.6. ofrimi i informatave për çështje gjyqësor brenda afatit kohor të arsyeshme dhe qasje në dokumente publike;
- 1.3.7. aktivitete, bashkëpunimi dhe partneriteti me organizatat e shoqëris civile.

1.4. Rastet specifike të vlerësimit:

- 1.4.1. zbatimimi i planeve strategjike të Këshillit për reduktimin e lëndëve me prioritet dhe lëndëve të vjetra;
- 1.4.2. inicimi dhe trajtimi i rasteve disiplinore;
- 1.4.3. trajtimi / zgjidhja e lëndëve nga ana e kryetarit;
- 1.4.4. pjesëmarrja në trajnime gjyqësore, përveç nëse janë përjashtuar nga përcjellja e trajnimeve;
- 1.4.5. pjesëmarrja në aktivitetet e Këshillit në përpilimin e planeve strategjike, akteve dhe dokumenteve tjera, si dhe pjesëmarrja në komisionet e themeluara nga Këshilli.

2. Subjektet e vlerësimit të performancës, poentimin sipas kriterve dhe nënkritereve të përcaktuara me paragrafin 1 të këtij neni do ta bëjnë sipas formularëve standardë të cilët janë pjesë e kësaj rregullore.

Neni 11

Kriteret e vlerësimit të performancës për gjyqtar mbikëqyrës

1. Gjyqtari mbikëqyrës do të vlerësohet në bazë të kriterëve dhe nën kriterëve të caktuara:

1.1. Organizimi dhe udhëheqja e punës së degës së gjykatës:

- 1.1.1. organizimi dhe udhëheqja e drejtë me burimet njerëzore;
- 1.1.2. sigurimi i kushteve për punën e gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe të punësuarave tjetër;
- 1.1.3. organizimi dhe mbajta e takimeve të rregullta të punës, me gjyqtarë të degës, si dhe me administratën e degës;
- 1.1.4. raportet tremujore të dërguara kryetarit të gjykatës që përfshinë rezultatet, vështirësitë si dhe propozimet për zgjedhjen e problemeve të identifikuara me të cilat ballafaqohet dega përkatëse;
- 1.1.5. zbatimimi i planeve strategjike, rregulloreve dhe akteve tjera të miratuara nga Këshilli.

1.2. Efikasiteti i punës së degës së gjykatës:

- 1.2.1. rezultatet në realizimin e planit vjetor për menaxhimin e lëndëve;
- 1.2.2. mënyra e caktimit të lëndëve brenda departamentit sipas akteve të miratuara në

Këshill;

- 1.2.3. trajtimi i lëndëve të caktuara me prioritet si dhe evitimin e parashkrimit të lëndëve;
- 1.2.4. rezultatet krahasuese në raport me numrin e lëndëve të pranuar dhe numrin e lëndëve të zgjidhura, në të gjitha lëmit;
- 1.2.5. përdorimi dhe monitorimi i përdorimit të SMIL-it.

1.3. Transparenca:

- 1.3.1. krijimin e kushteve për qasjen e qytetarëve pa dallim, përfshirë pjesëmarrjen e qytetarëve në seancat e hapura për publikun, pranimin e shërbimeve gjyqësore dhe administrative;
- 1.3.2. komunikimi me publikun për çështjet gjyqësore (dita e hapur e degës së gjykatës);
- 1.3.3. përgatitja e komunikatave të lëshuara në lidhje me rastet gjyqësore dhe aktivitete tjera brenda degës;
- 1.3.4. publikimi i aktgjykimeve dhe aktvendimeve të përcaktuara me akte të miratuara në Këshill për publikim.

1.4. Rastet specifike të vlerësimit:

- 1.4.1. zbatimi i planeve strategjike të Këshillit për reduktimin e lëndëve me prioritet dhe lëndëve të vjetra;
- 1.4.2. pjesëmarrja në trajnime gjyqësore, përveç nëse janë përjashtuar nga përcjellja e trajnimeve;
- 1.4.3. pjesëmarrja në aktivitetet e Këshillit në përpilimin e planeve strategjike, akteve dhe dokumenteve tjera, si dhe pjesëmarrjen në komisionet e themeluara nga Këshilli.

2. Subjektet e vlerësimit të performancës, poentimin sipas kriterve dhe nënkritereve të përcaktuara me paragrafin 1 të këtij neni do ta bëjnë sipas formularëve standard të cilët janë pjesë e kësaj rregullore.

Neni 12

Burimet e informacionit për vlerësimin të performancës për kryetarin e gjykatës

1. Burimet e informacionit që përdoren për vlerësimin e kryetarit të gjykatës janë:

- 1.1. dosja personale e kryetarit i cili është subjekt i vlerësimit;
- 1.2. raporti tre (3) mujor dhe vjetor i gjykatës;
- 1.3. raporti statistikor i hartuar nga Zyra për Statistika në Këshill, si dhe raportet e komisioneve përkatëse që monitorojnë punën e kryetarëve të gjykatave;
- 1.4. plani dhe raporti vjetor i punës dhe planet strategjike të gjykatës;
- 1.5. rendi i ditës së takimeve të kryetarit dhe procesverbali i takimeve;
- 1.6. komunikatat e gjykatës;
- 1.7. kërkesat e parashtruara Këshillit që kanë të bëjnë me krijimin e kushteve të punës;
- 1.8. agjendat e punëtorive, konferencave, takimeve të ndryshme, ftesat për pjesëmarrje në organizimet nga institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare ku merr pjesë subjekti i vlerësimit;
- 1.9. kërkesat, procedurat e iniciuara / dhe vendimet disiplinore;

- 1.10. çfarëdo veprimi apo dokumenti tjetër zyrtar që përmban informacione objektive dhe relevante lidhur me aktivitetet profesionale dhe sjelljen personale që ndikon në vlerësimin e subjektit të vlerësimit;
- 1.11. trajnimet nga Akademia e Drejtësisë dhe të tjera.

Neni 13

Burimet e informacionit për vlerësimin të performancës për gjyqtar mbikëqyrës

1. Burimet e informacionit që përdoren për vlerësimin e gjyqtarit mbikëqyrës janë:

- 1.1. dosja personale e gjyqtarit mbikëqyrës i cili është subjekt i vlerësimit;
- 1.2. raporti tre (3) mujor i degës;
- 1.3. raporti statistikor i hartuar nga Zyra për Statistika në Këshill si dhe raportet përkatëse që monitorojnë punën e degës;
- 1.4. plani dhe raporti vjetor i punës së gjykatës, ku bën pjesë dega;
- 1.5. rendi i ditës së takimeve të kolegjiutit, dhe procesverbali i takimeve;
- 1.6. kërkesat e parashtruara kryetarit të gjykatës / Këshillit që kanë të bëjnë me krijimin e kushteve të punës;
- 1.7. informatat lidhur me takimet e ndryshme me qytetarët apo komunikimet e tjera;
- 1.8. agjendën e punëtorive, konferencave, takimeve të ndryshme, ftesat për pjesëmarrje në organizimet nga institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare për pjesëmarrje të subjektit të vlerësimit;
- 1.9. çfarëdo veprimi apo dokumenti tjetër zyrtar që përmban informacione objektive dhe relevante lidhur me aktivitetet profesionale dhe sjelljen personale që ndikon në aktivitetet profesionale të subjektit vlerësues;
- 1.10. trajnimet nga Akademia e Drejtësisë dhe të tjera.

Neni 14

Shkallët e vlerësimit

1. Shkallët e vlerësimit të performancës së kryetarëve dhe gjyqtarëve mbikëqyrës, janë si në vijim:

- 1.1. prej 0 deri në 35 pikë vlerësohet “dobët”;
- 1.2. mbi 35 deri në 55 pikë vlerësohet “mjaftueshëm”;
- 1.3. mbi 55 deri në 75 pikë vlerësohet “mirë”;
- 1.4. mbi 75 deri në 90 pikë vlerësohet “shumë mirë”;
- 1.5. mbi 90 deri në 100 pikë vlerësohet “shkëlqyeshëm”.

Neni 15

Raporti përfundimtar i vlerësimit

1. Komisioni vlerësues mban seancë dhe harton raportin përfundimtar për vlerësimin e performancës së kryetarit të gjykatës. Raporti i cili duhet të përmbaj edhe këshillën juridike për të drejtën në ankesë, i përcjelllet kryetarit të gjykatës.

2. Kryetari i gjykatës si subjekt vlerësues, me rastin e vlerësimit të performancës së gjyqtarit mbikëqyrës harton raportin përfundimtar për vlerësimin e bërë. Raporti i cili duhet të përmbajë edhe këshillën juridike për të drejtën në ankesë, i përcjellet gjyqtarit mbikëqyrës.

Neni 16 **E drejta në ankesë**

1. Subjekti i vlerësuar në rast të mos pajtimit me raportin përfundimtar të vlerësimit të performancës së tij, mund të paraqesë ankesë në Këshill, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të raportit / njoftimit.

2. Pas pranimit të ankesës, stafi mbështetës përgatitë dosjen e nevojshme për ankesën dhe ia dërgon Këshillit për shqyrtim. Këshilli lidhur me ankesën vendos në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të saj.

3. Këshilli mund të hedh poshtë, refuzojë ose miratojë ankesën.

4. Në rastet kur Këshilli e miraton ankesën, procesi i ri - vlerësimit kryhet nga ana e Këshillit, pas marrjes së burimeve shtesë të informacionit nga subjekti i vlerësuar apo zyra relevante, jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë, duke llogaritur nga dita kur edhe është aprovuar ankesa.

5. Në rastet kur vlerësimi i performancës së kryetarit të gjykatës / gjyqtarit mbikëqyrës, rezulton me shkallën “mjaftueshëm”, subjekti vlerësues rekomandon masa shtesë – trajnime specifike, për përmirësimin e punës së kryetarit të gjykatës / gjyqtarit mbikëqyrës, të cilat duhet të ndiqen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e miratuara në Këshill.

Neni 17 **Transparenca**

Raporti në lidhje me vlerësimin e performancës së subjektit të vlerësimit bëhet publik deri në masën sa nuk rrezikohet konfidencialiteti lidhur me identitetin e tyre. Këto të dhëna bëhen pjesë e raportit vjetor të Këshillit.

Neni 18 **Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet dispozitat e kapitullit III të Rregullores Nr. 09/2016 për Procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, dhe të gjithave akteve tjera nënligjore që bien në kundërshtim me këtë rregullore.

Neni 19 **Dispozitat kalimtare**

Këshilli, harton dhe miraton Udhëzuesin për vlerësimin e performancës së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës në afat prej gjashtë (6) muajve pas miratimit të kësaj rregullore.

Neni 20
Shtojcat

1. Shtojca që i janë bashkangjitur kësaj rregullore janë pjesë përbërëse të saj:
 - 1.1. Shtojca 1: formulari për vlerësim të performancës së kryetarit të gjykatës nga anëtari i komisionit vlerësues;
 - 1.2. Shtojca 2: formulari për vlerësim të performancës së kryetarit të gjykatës nga komisioni vlerësues;
 - 1.3. Shtojca 3: formulari i vlerësimit të performancës së gjyqtarit mbikëqyrës nga kryetari i gjykatës;
 - 1.4. Shtojca 4: forma standarde e raportit përfundimtar të vlerësimit të performancës për kryetarin e gjykatës; si dhe,
 - 1.5. Shtojca 5: forma standarde e raportit përfundimtar të vlerësimit të performancës për gjyqtarin mbikëqyrës.

Neni 21
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

 Albert Zogaj,
[Signature]

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Datë: 10 . 01 . 2023



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË KRYETARIT TË GJYKATËS

KVPK.

nr.

/

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me Vendimin KGJK.nr.

/

të datës:

ka themeluar Komisionin

Për vlerësimin e performancës së kryetarit të Gjykatës _____

Në bazë të Rregullores Nr.13/2022 për Vlerësimin e Performancës së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, njofton Kryetarin e Gjykatës _____, për vlerësimin e performancës.

Komisioni për Vlerësimin e Kryetarit të Gjykatës në këtë përbërje:

1.	_____	Kryetar i Komisionit,
2.	_____	Anëtar I Komisionit dhe
3.	_____	Anëtar i Komisionit.

Komisioni me datë _____ ka mbajtur takimin e parë, në të cilin është autorizuar mbledhja e informacioneve - dokumentacionit për vlerësimin e performancës së kryetarit, bazuar në nenin _____ të Rregullores Nr. 13/2022 dhe shtojcës 1 dhe 2, si dhe Udhëzuesit, pjesë integrale e kësaj rregulloreje.

Komisioni më datë _____ ka mbajtur takimin e dytë, në të cilin është bërë shqyrtimi i informacioneve - dokumentacionit të dosjes, të siguruar për vlerësimin e performancës.

Komisioni më datë _____ ka mbajtur takimin e tretë, në të cilin, pas vlerësimit individual të secilit prej anëtarëve të Komisionit është bërë përmbledhja e pikëve në formularin përfundimtar.

Z/ znj. _____, me vendimin KGJK.nr. _____ / _____; të datës: _____

është zgjedhur Kryetar i Gjykatës _____, pozitë të cilën vazhdon ta mbajë ende.

Vlerësimi i performancës bëhet për periudhën:

deri më

Komisioni për vlerësimin e performancës së Kryetarit të Gjykatës _____,
z./znj. _____, konform Rregullores Nr. 13/2022 pas përfundimit të vlerësimit të
performancës, po ashtu i dorëzon Kryetarit raportin përfundimtar në lidhje me vlerësimin e tij .

VLERËSIMI I KRITEREVE ËSHTË BËRË SI NË VIJIM:

Kriteri 1.1. - Organizimi dhe udhëheqja e punës së gjykatës. Për këtë kriter mund të vlerësohet deri në 25 pikë.

Nën kriteri 1.1.1. Organizimi, udhëheqja dhe shpërndarja e drejtë me burimet njerëzore.

Vlerësimi është nga 0 deri 5 pikë	Kryetari është vlerësuar me		pikë.
-----------------------------------	-----------------------------	--	-------

Nën kriteri 1.1.2. Sigurimi i kushteve për punën e gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe të punësuarve të tjerë.

Vlerësimi është nga 0 deri 5 pikë	Kryetari është vlerësuar me		pikë.
-----------------------------------	-----------------------------	--	-------

Nën kriteri 1.1.3. Organizimi dhe mbajta e takimeve të rregullta të punës me gjyqtarë të gjykatës, takimeve me gjyqtarë

mbikëqyrës, si dhe me administratën. Vlerësimi është nga 0 deri 5 pikë	Kryetari është vlerësuar me		pikë.
--	-----------------------------	--	-------

Nën kriteri 1.1.4. Raportet tremujore/vjetore të dërguara në Këshill që përfshinë rezultatet, vështirësitë si dhe propozimet për zgjedhjen e problemeve të identifikuara me të cilat ballafaqohet gjykata përkatëse.

Vlerësimi është nga 0 deri 5 pikë	Kryetari është vlerësuar me		pikë.
-----------------------------------	-----------------------------	--	-------

Nën kriteri 1.1.5. Zbatimi i planeve strategjike, rregulloreve dhe akteve tjera të miratuara nga Këshilli.

Vlerësimi është nga 0 deri 5 pikë	Kryetari është vlerësuar me		pikë.
-----------------------------------	-----------------------------	--	-------

Totali i përgjithshëm i pikëve për kriterin 1.1.	0	pikë
---	----------	-------------

ARSYETIM:

Kriteri 1.2. - Efikasiteti i punës së gjykatës. Për këtë kriter mund të vlerësohet deri në 30 pikë

Nën kriteri 1.2.1. Rezultatet në realizimin e planit vjetor për menaxhimin e lëndëve.

Vlerësimi është nga 0 deri 5 pikë	Kryetari është vlerësuar me		pikë.
-----------------------------------	-----------------------------	--	-------

Nën kriteri 1.2.2. Mënyra e caktimit të lëndëve tek departamentet sipas akteve të miratuara në Këshill.

Vlerësimi është nga 0 deri 5 pikë	Kryetari është vlerësuar me		pikë.
-----------------------------------	-----------------------------	--	-------

Nën kriteri 1.2.3. Trajtimi i lëndëve të caktuara me prioritet si dhe evitimin e parashkrimit të lëndëve

Vlerësimi është nga 0 deri 5 pikë	Kryetari është vlerësuar me		pikë.
-----------------------------------	-----------------------------	--	-------

Nën kriteri 1.2.4. Seancat e shtyra dhe të anuluarat dhe ndërmarrja e masave për evitimin e shtyrjeve dhe anulimin e seancave gjyqësore. Vlerësimi është nga 0 deri 5 pikë

Vlerësimi është nga 0 deri 5 pikë	Kryetari është vlerësuar me		pikë.
-----------------------------------	-----------------------------	--	-------

Nën kriteri 1.2.5. Rezultatet krahasuese në raport me numrin e lëndëve të pranuarat dhe numrin e lëndëve të zgjidhura në të

gjitha lëmitë. Vlerësimi është nga 0 deri 5 pikë	Kryetari është vlerësuar me		pikë.
--	-----------------------------	--	-------

Nën kriteri 1.2.6. Përdorimi i SMIL-it dhe monitorimi i përduruesve të saj.		
Vlerësimi është nga 0 deri 5 pikë	Kryetari është vlerësuar me	pikë.
Totali i përgjithshëm i pikëve për kriterin 1.2.		0 pikë
ARSYETIM:		

Kriteri 1.3. - Transparenca . Për këtë kriter mund të vlerësohet deri në 21 pikë.		
Nën kriteri 1.3.1. Krijimin e kushteve për qasjen e qytetarëve pa dallim, përfshirë pjesëmarrjen e qytetarëve në seancat e hapura për publikun, pranimin e shërbimeve gjyqësore dhe administrative.		
Vlerësimi është nga 0 deri 3 pikë	Kryetari është vlerësuar me	pikë.
Nën kriteri 1.3.2. Komunikimi me publikun për çështjet gjyqësore (Dita e hapur e Gjykatës).		
Vlerësimi është nga 0 deri 3 pikë	Kryetari është vlerësuar me	pikë.
Nën kriteri 1.3.3. Tërësinë e komunikatave të lëshuara në lidhje me rastet gjyqësore dhe aktivitete tjera të gjykatës.		
Vlerësimi është nga 0 deri 3 pikë	Kryetari është vlerësuar me	pikë.
Nën kriteri 1.3.4. Kualiteti, azhurnimi me të dhëna dhe funksionimi i faqes zyrtare të gjykatës.		
Vlerësimi është nga 0 deri 3 pikë	Kryetari është vlerësuar me	pikë.
Nën kriteri 1.3.5. Publikimi i aktgjyqimeve dhe aktvendimeve tjera të përcaktuara me akte të miratuara të Këshillit për publikim.		
Vlerësimi është nga 0 deri 3 pikë	Kryetari është vlerësuar me	pikë.
Nën kriteri 1.3.6. Ofrimi i informatave për çështje gjyqësor brenda afatit kohor të arsyeshëm qasje në dokumente publike.		
Vlerësimi është nga 0 deri 3 pikë	Kryetari është vlerësuar me	pikë.
Nën kriteri 1.3.7. Aktiviteti, bashkëpunimi dhe partneriteti me organizatat e shoqërisë civile.		
Vlerësimi është nga 0 deri 3 pikë	Kryetari është vlerësuar me	pikë.
Totali i përgjithshëm i pikëve për kriterin 1.3.		0 pikë
ARSYETIM:		

Kriteri 1.4. - Rastet specifike të vlerësimit. Për këtë kriter mund të vlerësohet deri në 24 pikë.		
Nën kriteri 1.4.1. Zbatimi i planeve strategjike të Këshillit për reduktimin e lëndëve me prioritet dhe lëndëve të vjetra		
Vlerësimi është nga 0 deri 4.8 pikë	Kryetari është vlerësuar me	pikë.
Nën kriteri 1.4.2. Inicimi dhe trajtimi i rasteve disiplinore.		
Vlerësimi është nga 0 deri 4.8 pikë	Kryetari është vlerësuar me	pikë.
Nën kriteri 1.4.3. Trajtimi/ zgjidhja e lëndëve nga ana e kryetarit.		
Vlerësimi është nga 0 deri 4.8 pikë	Kryetari është vlerësuar me	pikë.

Nën kriteri 1.4.4. Pjesëmarrja në trajnime gjyqësore, përveç nëse janë përjashtuar nga përcjellja e trajnimeve.

Vlerësimi është nga 0 deri 4.8 pikë

Kryetari është vlerësuar me

pikë.

Nën kriteri 1.4.5. Pjesëmarrja në aktivitetet e Këshillit në përpilimin e planeve strategjike, akteve dhe dokumenteve tjera, si dhe pjesëmarrja në komisionet e themeluara nga Këshilli.

Vlerësimi është nga 0 deri 4.8 pikë

Kryetari është vlerësuar me

pikë.

Totali i përgjithshëm i pikëve për kriterin 1.4. 0 pikë

ARSYETIM:

TOTALI FINAL I VLERËSIMIT 0.0 PIKË

Datë: ____/____/____.

(dita) (muaji) (viti)

1. _____, Kryetar i Komisionit, _____
(emri dhe mbiemri) (pozita) (nënshkrimi)
2. _____, Anëtar i Komisionit, _____
(emri dhe mbiemri) (pozita) (nënshkrimi)
3. _____, Anëtar i Komisionit, _____
(emri dhe mbiemri) (pozita) (nënshkrimi)

Këshilla juridike: Kundër vlerësimit të performancës mund të ushtroni ankesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të raportit/njoftimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDESKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË GJYQTARIT MBIKËQYRËS

Kryetari i Gjykatës _____ në bazë të nenit 5 Rregullores Nr. 13/2022 për Vlerësimin e Performancës së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës është kompetent për vlerësimin e performancës së Z/znj. _____, Gjyqtar/e mbikëqyrës në Gjykatën _____
Dega në _____.

Kryetari i Gjykatës bazuar në nenin 11 dhe 13 të Rregullores Nr. 13/2022 për Vlerësimin e Performancës së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës si dhe shtojcës 3 pjese integrale e kësaj rregullore, pas shqyrtimit dhe analizimit të informacioneve dhe dokumentacionit të grumbulluar ka bërë vlerësimin e performancës së gjyqtarit mbikëqyrës.

Z/ znj. _____, me vendimin KGJK.nr. _____/_____; të datës: _____
është zgjedhur Gjyqtar mbikëqyrës i Gjykatës _____, dega në _____
pozitivë të cilën vazhdon ta mbajë ende.

Vlerësimi i performancës bëhet për periudhën: _____ deri më _____

Kryetari i Gjykatës _____, z./znj. _____, konform nenit 15 të Rregullores Nr. _____/_____ pas përfundimit të vlerësimit të performancës, i dorëzon Gjyqtarit mbikëqyrës raportin përfundimtar në lidhje me vlerësimin e tij.

VLERËSIMI I KRITEREVE ËSHTË BËRË SI NË VIJIM:

Kriteri 1.1. - Organizimi dhe udhëheqja e punës së degës së gjykatës. Për këtë kriter mund të vlerësohet deri në 30 pikë.

Nën kriteri 1.1.1. Organizimi, udhëheqja dhe shpërndarja e drejtë me burimet njerëzore.

Vlerësimi është nga 0 deri 6 pikë _____ Gjyqtari mbikëqyrës është vlerësuar _____ pikë.

Nën kriteri 1.1.2. Sigurimi i kushteve për punën e gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe të punësuarve të tjerë.

Vlerësimi është nga 0 deri 6 pikë _____ Gjyqtari mbikëqyrës është vlerësuar _____ pikë.

Nën kriteri 1.1.3. Organizimi dhe mbajta e takimeve të rregullta të punës, me gjyqtarë të degës dhe me administratën e degës.

Vlerësimi është nga 0 deri 6 pikë _____ Gjyqtari mbikëqyrës është vlerësuar _____ pikë.

Nën kriteri 1.1.4. Raportet tremujore të dërguara Kryetarit të gjykatës që përfshinë rezultatet, vështirësitë si dhe propozimet për zgjedhjen e problemeve të identifikuara me të cilat ballafaqohet dega përkatëse.

Vlerësimi është nga 0 deri 6 pikë _____ Gjyqtari mbikëqyrës është vlerësuar _____ pikë.

Nën kriteri 1.1.5. Zbatimi i planeve strategjike, rregulloreve dhe akteve tjera të miratuara nga Këshilli.

Vlerësimi është nga 0 deri 6 pikë _____ Gjyqtari mbikëqyrës është vlerësuar _____ pikë.

Totali i përgjithshëm i pikëve për kriterin 1.1. 0 pikë

ARSYETIM:

Kriteri 1.2. - Efikasiteti i punës së degës së gjykatës. Për këtë kriter mund të vlerësohet deri në 35 pikë

Nën kriteri 1.2.1. Rezultatet në realizimin e planit vjetor për menaxhimin e lëndëve.

Vlerësimi është nga 0 deri 7 pikë Gjyqtari mbikëqyrës është vlerësuar pikë.

Nën kriteri 1.2.2. Mënyra e caktimit të lëndëve brenda departamentit sipas akteve të miratuara në Këshill.

Vlerësimi është nga 0 deri 7 pikë Gjyqtari mbikëqyrës është vlerësuar pikë.

Nën kriteri 1.2.3. Trajtimi i lëndëve të caktuara me prioritet si dhe evitimin e parashkrimit të lëndëve.

Vlerësimi është nga 0 deri 7 pikë Gjyqtari mbikëqyrës është vlerësuar pikë.

Nën kriteri 1.2.4. Rezultatet krahasuese në raport me numrin e lëndëve të pranuar dhe numrin e lëndëve të zgjidhura në të

gjitha lëmitë. Vlerësimi është nga 0 deri 7 pikë Gjyqtari mbikëqyrës është vlerësuar pikë.

Nën kriteri 1.2.5. Përdorimi i SMIL-it dhe monitorimi i përdorimit të SMIL-it.

Vlerësimi është nga 0 deri 5 pikë Gjyqtari mbikëqyrës është vlerësuar pikë.

Totali i përgjithshëm i pikëve për kriterin 1.2. 0 pikë

ARSYETIM:

Kriteri 1.3. - Transparenca. Për këtë kriter mund të vlerësohet deri në 20 pikë.

Nën kriteri 1.3.1. Krijimin e kushteve për qasjen e qytetarëve pa dallim, përfshirë pjesëmarrjen e qytetarëve në seancat e hapura për publikun, pranimin e shërbimeve gjyqësore dhe administrative.

Vlerësimi është nga 0 deri 5 pikë Gjyqtari mbikëqyrës është vlerësuar pikë.

Nën kriteri 1.3.2. Komunikimi me publikun për çështjet gjyqësore (Dita e hapur e Gjykatës).

Vlerësimi është nga 0 deri 5 pikë Gjyqtari mbikëqyrës është vlerësuar pikë.

Nën kriteri 1.3.3. Përgaditja e komunikatave të lëshuara në lidhje me rastet gjyqësore dhe aktivitete tjera brenda degës.

Vlerësimi është nga 0 deri 5 pikë Gjyqtari mbikëqyrës është vlerësuar pikë.

Nën kriteri 1.3.5. Publikimi i aktgjyqimeve dhe aktvendimeve tjera të përcaktuara me akte të miratuara të Këshillit për publikim.

Vlerësimi është nga 0 deri 3 pikë Gjyqtari mbikëqyrës është vlerësuar pikë.

Totali i përgjithshëm i pikëve për kriterin 1.3. 0 pikë

ARSYETIM:

Kriteri 1.4. - Rastet specifike të vlerësimit. Për këtë kriter mund të vlerësohet deri në 15 pikë.

Nën kriteri 1.4.1. Zbatimi i planeve strategjike të Këshillit për reduktimin e lëndëve me prioritet dhe lëndëve të vjetra

Vlerësimi është nga 0 deri 5 pikë Gjyqtari mbikëqyrës është vlerësuar pikë.

Nën kriteri 1.4.2. Pjesëmarrja në trajnime gjyqësore, përveç nëse janë përjashtuar nga përcjellja e trajnimeve.

Vlerësimi është nga 0 deri 5 pikë Gjyqtari mbikëqyrës është vlerësuar pikë.

Nën kriteri 1.4.3. Pjesëmarrja në aktivitetet e Këshillit në përpilimin e planeve strategjike, akteve dhe dokumenteve

tjera, si dhe pjesëmarrja në komisionet e themeluara nga Këshilli.

Vlerësimi është nga 0 deri 5 pikë

Gjyqtari mbikëqyrës është vlerësuar

pikë.

Totali i përgjithshëm i pikëve për kriterin 1.4. 0.0 pikë

ARSYETIM:

TOTALI FINAL I VLERËSIMIT 0.0 PIKË

GJYKATA _____

Datë: ____/____/____.

(dita) (muaji) (viti)

1. _____,
(emri dhe mbiemri)

Kryetar i Gjykatës,
(pozita)

(nënshkrimi)

Këshilla juridike: Kundër vlerësimit të performancës mund të ushtroni ankesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të raportit/njoftimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

FORMULARI I VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË KRYETARIT TË GJYKATËS NGA ANËTARI I KOMISIONIT

Emri dhe mbiemri i të vlerësuarit						
Gjykata në të cilën i vlerësuarit është Kryetar						
Periudha e vlerësimit	nga:			deri:		
Emri dhe mbiemri i vlerësuesit						
Pozita që mban në Komision vlerësimi						
Data e përfundimit të vlerësimit		(data)		(muaji)		(viti)
Nënshkrimi i vlerësuesit						

Rezultati përfundimtar i vlerësimit, të Kryetarit të Gjykatës, nga anëtari i komisionit: 0 pikë.

** Kriteret e vlerësimit të performancës për Kryetarin e Gjykatës sipas Neni 10 paragrafi 2 I Rregullores Nr. 13/2022 për Vlerësimin e Performancës së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës. Maksimumi i pikëve të fituara nga rezultatit përfundimtar i vlerësimit të kryetarit të Gjykatës, nga anëtari i Komisionit është 100 pikë.*

Kriteri 1.1 - Organizimi dhe udhëheqja e punës së gjykatës. Maksimumi i pikëve në këtë kriter:	25	pikë.	Maksimumi i pikëve për secilin nënkriter:	0 - 5	pikë
Nën kriteri 1.1.1 Organizimi, udhëheqja dhe shpërndarja e drejtë me burimet njerëzore.	Vlerësimi:		pikë		

Nën kriteri 1.1.2 Sigurimi i kushteve për punën e gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe të punësuarve të tjerë.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.1.3 Organizimi dhe mbajta e takimeve të rregullta të punës me gjyqtarë të gjykatës, takimeve me gjyqtarë mbikëqyrës, si dhe me administratën.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.1.4 Raportet tremujore/vjetore të dërguara në Këshill që përfshinë rezultatet, vështirësitë si dhe propozimet për zgjedhjen e problemeve të identifikuara me të cilat ballafaqohet gjykata përkatëse.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.1.5 Zbatimi i planeve strategjike, rregulloreve dhe akteve tjera të miratuara nga Këshilli.	Vlerësimi:		pikë
Vlerësimi për Kryetarin e gjykatës, nga Anëtari i komisionit, për kriterin 1.1		0	pikë
Kriteri 1.2 - Efikasiteti i punës së gjykatës.	Maksimumi i pikëve në këtë kriter:	30	pikë.
	Maksimumi i pikëve për secilin nënkriter:	0 - 5	pikë
Nën kriteri 1.2.1 Rezultatet në realizimin e planit vjetor për menaxhimin e lëndëve.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.2.2 Mënyra e caktimit të lëndëve tek departamentet sipas akteve të miratuara në Këshill.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.2.3 Trajtimi i lëndëve të caktuara me prioritet si dhe evitimin e parashkrimit të lëndëve.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.2.4 Seancat e shtyra dhe të anuluar dhe ndërmarrja e masave për evitimin e shtyrjeve dhe anulimin e seancave gjyqësore.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.2.5 Rezultatet krahasuese në raport me numrin e lëndëve të pranuar dhe numrin e lëndëve të zgjidhura në të gjitha lëmitë.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.2.6 Përdorimi i SMIL-it dhe monitorimi i përduruesve të saj.	Vlerësimi:		pikë
Vlerësimi për Kryetarin e gjykatës, nga Anëtari i komisionit, për kriterin 1.2		0.0	pikë
Kriteri 1.3 - Transparenca.	Maksimumi i pikëve në këtë kriter:	21	pikë.
	Maksimumi i pikëve për secilin nënkriter:	0 - 3	pikë
Nën kriteri 1.3.1 Krijimin e kushteve për qasjen e qytetarëve pa dallim, përfshirë pjesëmarrjen e qytetarëve në seancat e hapura për publikun, pranimin e shërbimeve gjyqësore dhe administrative.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.3.2 Komunikimi me publikun për çështjet gjyqësore (Dita e hapur e Gjykatës).	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.3.3 Tërësinë e komunikatave të lëshuara në lidhje me rastet gjyqësore dhe aktivitete tjera të gjykatës.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.3.4 Kualiteti, azhurnimi me të dhëna dhe funksionimi i faqes zyrtare të gjykatës.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.3.5 Publikimi i aktgjyqimeve dhe aktvendimeve tjera të përcaktuara me akte të miratuara të Këshillit për publikim.	Vlerësimi:		pikë

Nën kriteri 1.3.6 Ofrimi i informatave për çështje gjyqësor brenda afatit kohor të arsyeshëm qasje në dokumente publike.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.3.7 Aktiviteti, bashkëpunimi dhe partneriteti me organizatat e shoqërisë civile.	Vlerësimi:		pikë
Vlerësimi për Kryetarin e gjykatës, nga Anëtari i komisionit, për kriterin 1.3		0	pikë
Kriteri 1.4 - Rastet specifike të vlerësimit.	Maksimumi i pikëve në këtë kriter:	24	pikë.
	Maksimumi i pikëve për secilin nënkriter:	0 - 4.8	pikë
Nën kriteri 1.4.1 Zbatimi i planeve strategjike të Këshillit për reduktimin e lëndëve me prioritet dhe lëndëve të vjetra.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.4.2 Inicimi dhe trajtimi i rasteve disiplinore.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.4.3 Trajtimi/ zgjidhja e lëndëve nga ana e kryetarit.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.4.4 Pjesëmarrja në trajnime gjyqësore, përveç nëse janë përjashtuar nga përcjellja e trajnimeve.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.4.5 Pjesëmarrja në aktivitetet e Këshillit në përpilimin e planeve strategjike, akteve dhe dokumenteve tjera, si dhe pjesëmarrja në komisionet e themeluara nga Këshilli.	Vlerësimi:		pikë
Vlerësimi për Kryetarin e gjykatës, nga Anëtari i komisionit, për kriterin 1.4		0	pikë



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

FORMULARI I VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË KRYETARIT TË GJYKATËS NGA KOMISIONI VLERËSUES

Emri dhe mbiemri i të vlerësuarit						
Gjykata në të cilën i vlerësuarit është Kryetar						
Periodha e vlerësimit	nga:			deri:		

* Dispozita e nenit 10, paragrafi 1, pika 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 i Rregullores për Vlerësimin e Performancës së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës. Maksimumi i pikëve të fituara nga rezultatit përfundimtar i vlerësimit të kryetarit të Gjykatës, nga Komisioni i Vlerësimit është 100 pikë.

RAPORTI PËRMBLEDHËS I VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË KRYETARIT TË GJYKATËS NGA KOMISIONI VLERËSUES

Kriteret për vlerësim:	Pikët maksimale	Vlerësimi individual i performancës së Kryetarit nga secili anëtar			TOTALI
		Kryetari:	Anëtari:	Anëtari:	
Nën kriteri 1.1.1.	5				0.0
Nën kriteri 1.1.2.	5				0.0
Nën kriteri 1.1.3.	5				0.0
Nën kriteri 1.1.4.	5				0.0
Nën kriteri 1.1.5.	5				0.0
TOTAL: Kriteri 1.1.	25	0	0	0	0.0
Nën kriteri 1.2.1.	5				0.0
Nën kriteri 1.2.2.	5				0.0
Nën kriteri 1.2.3.	5				0.0
Nën kriteri 1.2.4.	5				0.0
Nën kriteri 1.2.5.	5				0.0
Nën kriteri 1.2.6.	5				0.0
TOTAL: Kriteri 1.2.	30	0	0	0	0.0
Nën kriteri 1.3.1.	3				0.0
Nën kriteri 1.3.2.	3				0.0
Nën kriteri 1.3.3.	3				0.0

Nën kriteri 1.3.4.	3				0.0
Nën kriteri 1.3.5.	3				0.0
Nën kriteri 1.3.6.	3				0.0
Nën kriteri 1.3.7.	3				0.0
TOTAL: Kriteri 1.3.	21	0	0	0	0.0
Nën kriteri 1.4.1.	4.8				0.0
Nën kriteri 1.4.2.	4.8				0.0
Nën kriteri 1.4.3.	4.8				0.0
Nën kriteri 1.4.4.	4.8				0.0
Nën kriteri 1.4.5.	4.8				0.0
TOTAL: Kriteri 1.4.	24	0	0	0	0.0
PIKËT MAKSIMALE TË MUNDSHME	100	0	0	0	0.0
TOTALI FINAL I VLERËSIMIT					0.0
SHKALLA E VLERËSIMIT					

DATE: ____/____/____

Komisioni për vlerësimin e përfomancës	Emri dhe mbiemri	Nënshkrimi
Kryetari i Komisionit		
Anëtari i Komisionit		
Anëtari i Komisionit		

* Udhëzimet për vlerësim në formularë nga ana e anëtarëve të Komisionit: Secili anëtar i Komisionit vendos pikët e vlerësimit individual në Raportin përmbledhës të vlerësimit për secilin nën kriter, nga Komisioni për vlerësim e Kryetarit të Gjykatës. Pikët e nënkritereve mbledhen në totalin e secilit kriter. Totalët e secilit kriter mbledhen duke fituar TOTALI FINAL I VLERËSIMIT. Duke pas parasysh se Komisioni përbëhet nga TRE (3) anëtar atëherë TOTALI i pikëve të vlerësimit pjestohet me TRE (3) duke na dhënë TOTALIN FINAL TË VLERËSIMIT NGA KOMISIONI për Kryetarin e Gjykatës.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

FORMULARI I VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË GJYQTARIT MBIKËQYRËS NGA KRYETARI I GJYKATËS

Emri dhe mbiemri i të vlerësuarit						
Gjykata/ dega në të cilën i vlerësuarit është Gjyqtar mbikëqyrës						
Periodha e vlerësimit	nga:				deri:	
Emri dhe mbiemri i vlerësuesit						
Pozita që mban vlerësuesi dhe Gjykata						
Data e përfundimit të vlerësimit		(data)		(muaji)		(viti)
Nënshkrimi i vlerësuesit						

Rezultati përfundimtar i vlerësimit, të Gjyqtarit mbikëqyrës, nga Kryetari i Gjykatës: 0 pikë.

** Kriteret e vlerësimit të performancës për Gjyqtarin Mbikëqyrës sipas Neni 11 i Rregullores Nr. 13/2022 për Vlerësimin e Performancës së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës. Maksimumi i pikëve të fituara nga rezultatit përfundimtar i vlerësimit të Gjyqtarit Mbikëqyrës, nga Kryetari i Gjykatës është 100 pikë.*

Kriteri 1.1 - Organizimi dhe udhëheqja e punës së degës së gjykatës.	Maksimumi i pikëve:	30	pikë.	Maksimumi i pikëve për secilin nënkriter:	0 - 6	pikë
Nën kriteri 1.1.1 Organizimi, udhëheqja dhe shpërndarja e drejtë me burimet njerëzore.	Vlerësimi:					pikë
Nën kriteri 1.1.2 Sigurimi i kushteve për punën e gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe të punësuarve tjerë.	Vlerësimi:					pikë

Nën kriteri 1.1.3 Organizimi dhe mbajta e takimeve të rregullta të punës, me gjyqtarë të degës si dhe me administratën e degës.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.1.4 Raportet tremujore të dërguara Kryetarit të Gjykatës që përfshinë rezultatet, vështirësitë si dhe propozimet për zgjedhjen e problemeve të identifikuara me të cilat ballafaqohet dega përkatëse	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.1.5 Zbatimi i planeve strategjike, rregulloreve dhe akteve tjera të miratuara nga Këshilli.	Vlerësimi:		pikë
Vlerësimi për Gjyqtarin mbikëqyrës, nga Kryetari i Gjykatës, për kriterin 1.1			0 pikë
Kriteri 1.2 - Efikasiteti i punës së degës së gjykatës.	Maksimumi i pikëve në këtë kriter:	35 pikë.	Maksimumi i pikëve për secilin nënkriter: 0 - 7 pikë
Nën kriteri 1.2.1 Rezultatet në realizimin e planit vjetor për menaxhimin e lëndëve.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.2.2 Mënyra e caktimit të lëndëve brenda departamentit sipas akteve të miratuara në Këshill	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.2.3 Trajtimi i lëndëve të caktuara me prioritet si dhe evitimin e parashkrimit të lëndëve.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.2.4 Rezultatet krahasuese në raport me numrin e lëndëve të pranuar dhe numrin e lëndëve të zgjidhura në të gjitha lëmit.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.2.5 Përdorimi dhe monitorimi i përdorimit të SMIL-it	Vlerësimi:		pikë
Vlerësimi për Gjyqtarin mbikëqyrës, nga Kryetari i Gjykatës, për kriterin 1.2			0.0 pikë
Kriteri 1.3 - Transparenca.	Maksimumi i pikëve në këtë kriter:	20 pikë.	Maksimumi i pikëve për secilin nënkriter: 0 - 5 pikë
Nën kriteri 1.3.1 Krijimin e kushteve për qasjen e qytetarëve pa dallim, përfshirë pjesëmarrjen e qytetarëve në seancat e hapura për publikun, pranimin e shërbimeve gjyqësore dhe administrative	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.3.2 Komunikimi me publikun për çështjet gjyqësore (Dita e hapur e Gjykatës).	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.3.3 Përgaditja e komunikatave të lëshuara në lidhje me rastet gjyqësore dhe aktivitete tjera brenda degës.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.3.4 Publikimi i aktgjykimeve dhe aktvendimeve tjera të përcaktuara me akte të miratuara të Këshillit për publikim.	Vlerësimi:		pikë
Vlerësimi për Gjyqtarin mbikëqyrës, nga Kryetari i Gjykatës, për kriterin 1.3			0 pikë
Kriteri 1.4 - Rastet specifike të vlerësimit.	Maksimumi i pikëve në këtë kriter:	15 pikë.	Maksimumi i pikëve për secilin nënkriter: 0 - 5 pikë
Nën kriteri 1.4.1 Zbatimi i planeve strategjike të Këshillit për reduktimin e lëndëve me prioritet dhe lëndëve të vjetra.	Vlerësimi:		pikë

Nën kriteri 1.4.2 Pjesëmarrja në trajnime gjyqësore, përveç nëse janë përjashtuar nga përcjellja e trajnimeve.	Vlerësimi:		pikë
Nën kriteri 1.4.3 Pjesëmarrja në aktivitetet e Këshillit në përpilimin e planeve strategjike, akteve dhe dokumenteve tjera, si dhe pjesëmarrja në komisionet e themeluara nga Këshilli.	Vlerësimi:		pikë
Vlerësimi për Gjyqtarin mbikëqyrës, nga Kryetari i Gjykatës, për kriterin 1.4			0 pikë